

**KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT
SH. A.**



Zyret qendrore
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë
Telefoni: 039 / 432 355
www.hidrodrini.com

Në bazë të nenit 7 pika 2 të Statutit të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë, vendimit Nr.prot.15/03/05/2018 të dt.29.05.2018 të Bordit të Drejtorëve, mbi ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi përdorimin e automjeteve zyrtare të Kompanisë, Bordi I Drejtorëve nxjerrë këtë:

Aneks Rregullore mbi përdorimin e automjeteve zyrtare në KRU “Hidrodrini” Sh. A.

Në bazë të Statutit të Shoqërisë si akt bazik i themelimit të shoqërisë KRU “ Hidrodrini” Sh. A. nr.biz. 70433918 dhe duke u bazuar në nenin 7 të Statutit të shoqërisë KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. për ndryshime dhe plotësime të Rregullores të brendshme, Bordi I Drejtorëve nxjerrë këtë Vendim për ndryshim dhe plotësim të Rregullores mbi përdorimin e automjeteve zyrtare të KRU “Hidrodrini” Sh. A. Pejë, si në vijim :

Neni 1

Ndryshohet neni 7 paragrafi 7.1 I Rregullores mbi përdorimin e automjeteve zyrtare të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë dhe tani e tutje do të je, si vijon:

Punëtori i cili e drejton automjetin zyrtar të Kompanisë për nevoja zyrtare duhet të plotësoj fletëudhëtimin dhe të njëjtin t’a dorëzoj tek përgjegjësi I tij.

Në rast të udhëtimit zyrtar jasht shtetit lëshohet autorizim I veçant nga KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë, për përdorimin e automjetit zyrtar dhe verifikohet tek noteri.

Neni 2

Ndryshohet neni 7 paragrafi 7.2 I Rregullores mbi përdorimin e automjeteve zyrtare të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë dhe tani e tutje do të jet si vijon:

Drejtuesi i automjetit zyrtar është i obliguar që para përdorimit të automjetit zyrtar të plotësoj formularin e udhëtimit.

Neni 3

Ndryshohet neni 7 paragrafi 7.3 I Rregullores mbi përdorimin e automjeteve zyrtare të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë dhe tani e tutje do të jet si vijon:

Të gjitha automjetet e shoqërisë me përjashtim të automjeteve zyrtare të Kryeshefit Ekzekutiv, ZLF, menaxherave të Njësive Operative dhe ekipeve kujdestare, pas përfundimit të orarit të punës, respektivisht përdorimit të automjetit, duhet të parkohen dhe të qëndrojnë në parkingjet e automjeteve të shoqërisë.

Neni 4

Ndryshohet neni 7 paragrafi 7.4 I Rregullores mbi përdorimin e automjeteve zyrtare të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë dhe tani e tutje do të jet si vijon:

Çelsat e automjeteve, pas përfundimit të udhëtimit, dorëzohen tek përgjegjësi për menaxhimin e automjeteve.

Neni 5

Ndryshohet neni 42 i Rregullores mbi përdorimin e automjeteve zyrtare të KRU “ Hidrodrini” Sh. A. Pejë dhe tani e tutje do të jet, si vijon:

Për përdorimin e automjetit privat nga punëtori i shoqërisë për kryerjen e punëve zyrtare, shoqëria mban obligimin për kompensimin e karburantit të shpenzuar dhe në emër të amortizimit të automjetit kompensimin prej 0.16 € për çdo kilometër të kaluar.

Neni 6

Nenet tjera të Rregullores mbi përdorimin e automjeve të KRU “ Hidrodrini “ Sh. A. Pejë mbesin të pandryshuara .

Neni 7

Ky Aneks i Rregullores hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Bordi i Drejtorëve .

I dërgohet:

- Bordit të Drejtorëve
- NjPMNP
- Në arkiv



z.Burim Basha (ing i dipl.)
Kryetar i Bordit të Drejtorëve